

2016
RAPORT VJETOR





FED
invest 

Rr. Qemal Stafa, Pazari i Ri, Nr.70

Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +3554225190/1

e-mail: info@fedinvest.al

www.fedinvest.al

PËRMBAJTJE

1. Mesazh nga Drejtorja Ekzekutive	03
2. Ngjarjet kryesore të vitit 2016	05
3. Treguesit e veprimtarisë	06
4. Zhvillime Institucionale	09
5. Projekte	11
6. Pasqyra financiare	14
7. Raporti i auditorit të jashtëm	16



Në foto: Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë së Kursim Kreditit FED invest, 25 Prill 2016.

KOOPERATIVA FINANCIARE MË E MADHE NË SHQIPËRI

FED invest është një Institucion financiar i zhvilluar mbi eksperiencën dhe ekspertizën e shoqërive të kursim kreditit në Shqipëri. Shtimi sasior dhe cilësor i aktivitetit të shoqërive të kursim kreditit solli natyrshëm nevojën për përmirësime strukturore me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të veprimeve të Institucionit ndaj anëtarëve të tij. Prej 25 vitesh, FED invest është kooperativa financiare e preferuar e fermerëve shqiptarë dhe katalizator i zhvillimit të agrikulturës në vend.

MESAZH NGA DREJTORJA EKZEKUTIVE

Të nderuar Lexues,

Në emër të FED invest, më lejoni të ndaj me Ju arritjet historike të vitit 2016, që transformuan në mënyrë rrënjësore Institucionin tonë.

Falë vizionit largpamës të Këshillit Drejtues, përpjekjeve maksimale të të zgjedhurve, ekipit drejtues dhe personelit tonë të përkushtuar, bashkëpunimit të shkëlqyer me partnerët tanë strategjikë, mbështetjes nga Qeveria Shqiptare e Banka e Shqipërisë, ne arritëm të konsolidoheshim në një Institucion të vetëm financiar, nën emrin SHKK FED invest, përmes bashkimit me përthithje të 70 SHKK-ve. Duke ruajtur e kultivuar vlerat më të mira demokratike të modelit tonë të qeverisjes si kooperativë financiare dhe synuar forcimin e marrëdhënies afatgjatë me anëtarët, direkt pranë komuniteteve lokale, ne ripërcaktuam misionin tonë si:

"Shërbimin e popullsisë së zonave rurale dhe atyre urbane me një shumëllojshmëri shërbimesh financiare, bazuar në teknologji moderne bankare".

Gjatë 2016-ës ne kapërcyem me sukses një seri sfidash vendimtare për të ardhmen afatgjatë dhe qëndrueshmërinë financiare të Institucionit tonë. Sot ndihemi krenarë që brenda një kohe rekord, ne plotësuam kuadrin rregullativ dhe operacional të FED invest, në përputhje të plotë me legjislacionin për shoqëritë e kursim-kreditit; siguruam licencën përkatëse nga Banka e Shqipërisë; u anëtarësuam në skemën e sigurimit të depozitave (ASD); ndërmorrëm zhvillime teknologjike të rëndësishme; zgjeruam gamën e shërbimeve ndaj anëtarësisë me produkte financiare dhe jo-financiare; fuqizuam kapacitetet tona njerëzore përmes prurjeve të reja dhe promovimit të atyre ekzistuese; përmirësuam cilësisht imazhin tonë dhe rrjetin e degëve etj.

Të gjitha këto përpjekje shtuan besimin e anëtarëve dhe u përkthyen në rritje të fuqishme të gjithë treguesve të biznesit, përfshi edhe cilësinë e portofolit. Ne sot, jemi zgjedhja e parë dhe e besuar për mbi 40 mijë anëtarë, me një nivel depozitash mbi 2,7 mld lekë, portofol kredie rreth 3 mld lekë, me një portofol në risk prej 5,42% ose tre herë më të ulët se ai i sektorit bankar shqiptar.

Ndërsa 2016-ta hodhi themelet e transformimit historik Institucional, kam bindjen se viti 2017 do të jetë, pa dyshim, një vit po aq përcaktues për FED invest, pasi shënon fillimin e zbatimit të projektit të përbashkët 3-vjeçar të asistencës teknike mes Qeverisë Holandeze, EFSE DF dhe RIAS.

Në vijim të përmbushjes së misionit tonë, edhe për vitin 2017, vit që përkon me 25 vjetorin e rrugëtimit të përbashkët në financat sociale, ne synojmë objektiva mjaft ambicioze: shtrirje në mbi 40% të zonave rurale në vend, rritje të totalit të aktiveve me 20%, rritje të portofolit të kredisë e depozitave me 15%, ofrim i teknologjive dhe produkteve të reja bankare, manaxhim pro-aktiv e më cilësor i riskut dhe zgjerim i partneriteteve strategjike.


Duke parë me optimizëm drejt së ardhmes, dua të rikonfirmoj edhe një herë se marrëdhënia solide me anëtarësinë, do të vazhdojë të jetë vendimtare për arritjet tona të ardhshme.

Me respekt,
Zana KONINI
Drejtoresh Ekzekutive



MISIONI YNË


Ne operojmë në mënyrë miqësore duke përdorur praktikat e bankingut modern dhe ofrojmë një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare, veçanërisht për popullsinë që jeton në zonat rurale të Shqipërisë, me qëllim përfshirjen financiare dhe reduktimin e përgjithshëm të varfërisë.



Antarët e Këshillit Drejtues:

1) Z. Mehdi Pepa - Kryetar, 2) Z. Valentin Gocaj - Nënkryetar, 3) Znj. Zana Konini - Anëtare, 4) Z. Namik Zeneli - Anëtar, 5) Z. Xhevdet Kapaj - Anëtar, 6) Z. Hasan Shehu - Anëtar, 7) Z. Zyjdi Boja - Anëtar


NGJARJET KRYESORE 2016



TREGUESIT KRYESORË TË VEPRIMTARISË GJATË VITIT 2016



Portofoli i Kredisë
(në miliardë Lekë)



PORTOFOLI I KREDISË

Rezultatet e vitit 2016 konfirmojnë një rritje të qëndrueshme në portofolin e kredisë, me një trend rritjeje më të lartë krahasuar me periudhën e vitit 2015. Portofoli i kredisë në 31.12.2016 paraqet një rritje prej 13.15% në krahasim me vitin 2015. Kjo rritje e portofolit të kredisë dëshmon për një konsolidim në vazhdim të aktivitetit, duke qënë gjithmonë në përgjigje të kërkesave në rritje të anëtarësisë. Vlen për t'u theksuar që rritja e portofolit të kredisë, konstatohet jo vetëm si rritje e volumit të kredisë, por edhe në numrin e kredive të disbursuara. Gjatë vitit 2016 janë disbursuar gjithsej 5,892 kredi, në vlerë mbi 2 miliardë lekë, kryesisht në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë. Gjatë këtij viti kreditë kanë qënë kryesisht të orientuara:

(i) për financimin e aktiviteteve bujqësore (kredi për sera, perime, pemëtari, vreshtari, ullishte) (ii) për financimin e aktiviteteve blegtorale (mbarështim gjedhësh, të imta, shpendësh) (iii) për financimin e aktiviteteve të ndryshme si në tregti, shërbime, agropërpunim, kredi familjare, etj.

CILËSIA E PORTOFOLIT TË KREDISË


Ruajtja e cilësisë së portofolit të kredisë brenda parametrave është një objektiv kryesor, që garanton qëndrueshmëri dhe konsolidim të Institucionit në vijmësi. Krahasuar me 31.12.2015 kemi një përmirësim të cilësisë së portofolit të kredisë me 4%. Në fund të vitit 2016 PaR-i rezultoi 5,42%. Minimizimi i riskut të kredisë vazhdon të jetë një ndër prioritetet kryesore të FED invest. Në këtë drejtim disa nga masat e mara për ruajtjen e cilësisë së portofolit brenda parametrave kanë qenë të fokusuar në përzgjedhjen e kujdesshme të klientëve huamarrës, analizë të thelluar të aktivitetit të financuar me kredi dhe një ndjekje më intensive e klientëve problematikë.

PRODUKTET SME

Një risi e vitit 2016 ishte ofrimi i produkteve SME. Nëpërmjet këtyre produkteve FED invest, ka bërë të mundur mbështetjen sipas kërkesave të anëtarëve, me shuma mbi 1.2 milionë lekë për investime në fermë, mekanikë bujqësore apo në përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale. FED invest është i përfshirë në programin SARED "Mbështetje për bujqësinë dhe zhvillimin rural në zonat e pa favorizuara në Shqipëri." Ky program është i bashkëfinancuar nga Qeveritë e Danimarkës dhe Gjermanisë, në përputhje me objektivat e strategjisë ndër-sektoriale të Zhvillimit Rural për Shqipërinë 2014-2020.


PORTOFOLI I DEPOZITAVE

Në fund të vitit 2016, portofoli i depozitave rezultoi me një rritje prej 14,8 % krahasuar me fundin e vitit 2015. Struktura e këtij portofoli është përmirësuar si në drejtim të diversifikimit të produkteve ashtu edhe të maturiteteve.



KONSOLIDIM INSTITUCIONAL

Numri i anëtarëve



Kërkesat në rritje të tregut dhe anëtarëve për produkte dhe shërbime financiare konkurruese u shoqëruan ndër vite me zgjerimin e rrjetit dhe diversitetit të shoqërive të kursim kreditit. Në këto kushte, pas një procesi të gjatë reflektimi nga lidhshipi i ShKK-ve, lindi nevoja për konsolidim të mëtejshëm Institucional. Ky proces konsolidimi u krye me mbështetjen e Bankës Botërore, Bankës së Shqipërisë, dhe RIAS.

Në Dhjetor 2015, Asambleja e Përgjithshme e SHKK-ve miratoi bashkimin vullnetar me përthithje të 70 SHKK-ve anëtare në shoqërinë përthithëse ekzistuese të kursim kreditit FED invest. Në 2 Mars 2016 Banka e Shqipërisë liçenoi Shoqërinë e Kursim Kreditit FED invest. Në 30 Nëntor 2016 Agjencia e Sigurimit të Depozitave i dorëzoi Shoqërisë së Kursim Kreditit FED invest Çertifikatën për Sigurimin e Depozitave deri në vlerën 2,000,000 Lekë.



ZHVILLIME INSTITUCIONALE

BURIMET NJERËZORE

Gjatë këtij viti departamenti i Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me strukturat e tjera dhe degët në rrethe, ka ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për realizimin e misionit të tij, lidhur me mbështetjen efiçase që duhet të japë për manaxhimin sa më të mirë të punës dhe stafit të FED invest. Krijimi i FED invest solli si domosdoshmëri rishikimin e strukturave ekzistuese dhe krijimin e njësive të reja në qendër dhe në rrethe. Fokusi i Burimeve Njerëzore ka qenë dhe do të mbetet rekrutimi i stafit me eksperiencë bankare apo në sektorin e mikrofinancës. Gjithashtu prioritet konstant i këtij departamenti mbetet ruajtja e balancave gjinore, për ruajtjen e ekuilibrit të duhur gjinor në politikat e tij. Aktualisht, 53.29% e stafit përbëhet nga punonjëse femra.

ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PROFESIONALE

FED invest vijon që të sigurojë dhe garantojë zhvillim profesional të punonjësve dhe të zgjedhurve të tij. Në këtë drejtim dhe në të njëjtën linjë me aktivitetin e tij të përgjithshëm dhe mbështetjen e jashtëzakonshme të KFW, USDA dhe JICA, FED invest ka mundur gjatë vitit 2016 trajnime brenda dhe jashtë vendit. Fokusi i këtyre trajnimeve ka qenë kryesisht mbi procesin e huasë, financave bujqësore, vlerësimin e riskut, marrëdhëniet me klientët, ngritjen e kooperativave dhe funksionimin e zinxhirit të vlerës. Subjekt të këtyre trajnimeve kanë qenë kryesisht oficerët e kredive, specialistët e riskut dhe të zgjedhurit e FED invest. Këto trajnime dhe kualifikime priten që të vazhdojnë me të njëjtën intensitet edhe gjatë vitit 2017.

IMAZHI I RI KORPORATIV

Krijimi i një SHKK-je të vetme, ndër të tjera, mundësoi fillimin e investimeve për hapjen e degëve të reja si në rajonet ekzistuese ashtu dhe në ato të reja. 12 degë të reja të hapura në rajonet e Tiranës, Fierit, Kuçovës, Urës Vajgurore, Lushnjes, Lezhës dhe Përmetit sollën përmirësimin e kushteve të shërbimit ndaj klientëve dhe atyre të punës në degët e FED invest. Ky program Institucional investimi synon transmetimin e ambicies të FED invest për një veprimtari me standarde të larta profesionale dhe bashkëkohore përmes imazhit të ri korporativ.



MBËSHTETJE NDËRKOMBËTARE



Në foto nga e majta në të djathtë: Znj. Zana Konini (Drejtoresh Ekzekutive FED invest), Znj. Dewi van de Weerd (Ambasadore e Vendeve të Ulta), Znj. Venera Hoxha (Eksperte e Investimeve, EFSE), Z. David Gerbrands (Drejtor i Këshillimit Bankar RIAS/Rabobank)

22 Shtator 2016 - Në mjediset e Ambasadës së Mbretërisë të Vendeve të Ulta u nënshkrua marrëveshja për fillimin e projektit: “Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve financiare, me qëllim zhvillimin ekonomik të Shqipërisë rurale”. Ky projekt financohet nga Ministria e Jashtme e Vendeve të Ulëta, Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE), Rabo International Adviser Services (RIAS) dhe FED invest.

PROJEKTE

PËRMIRËSIMI DHE ZGJERIMI I SHËRBIMEVE FINANCIARE, ME QËLLIM ZHVILLIMIN EKONOMIK TË SHQIPËRISË RURALE

Projekti në zbatim nga FED invest, me asistencën teknike të RIAS dhe EFSE, synon përmirësimin strukturor të përfshirjes financiare në Shqipëri, si kontribuese e zhvillimit të ekonomisë rurale dhe rritjen e nivelit të jetesës së popullsisë rurale. Objektivat afatgjatë të FED invest janë të lidhura me zbatimin cilësor të këtij projekti ambicioz, duke pasqyruar kështu aspiratat e FED invest që, mbështetur në lidhjen simbiotike të Institucionit me komunitetin rural, të bëhet aktori më i rëndësishëm i agro-financës në zonat rurale, financues i një numri më të madh sipërmarrjesh të vogla dhe të mesme, dhe ofrues i shërbimeve për të gjithë ata të cilët aktualisht nuk kanë akses në shërbimet financiare. Më konkretisht, ky projekt synon (i) përmirësimin e modelit qeverisës kooperativ, (ii) ngritjen e kapaciteteve lokale për zhvillimin agrobiznesit, (iii) zhvillimin e aftësive të biznesit të fermerëve, (iv) investimet në burimet njerëzore dhe (v) zhvillimin e modeleve të teknologjisë të informacionit.

ZGJERIMI I PËRFSHIRJES FINANCIARE NË SHQIPËRI



Më mbështetjen e Agjencisë Japoneze për Zhvillim Ndërkombëtar - Japan International Cooperation Agency (JICA) në fund të vitit 2016 përfundoi faza e parë e projektit për përmirësimin e përfshirjes financiare në Shqipëri. Qëllimi kryesor i këtij projekti ishte ekspozimi i stafit manaxherial të këtyre Institucioneve të mikrofinancës dhe fermerëve shqiptarë ndaj njohurive dhe praktikave më të mira mbi manaxhimin e (i) kooperativave (ii) qeverisjen dhe zhvillimin e

kapaciteteve (iii) edukimin financiar (iv) projektimin e produkteve për prodhimet jobujqësore (v) diversifikimin e produkteve për prodhimin bujqësor (vi) përfshirjen e grave dhe të rinjve dhe (vii) bankingun jashtë dege.

LINJË GARANCIE ME KOSTO TË ULËT NGA FONDI I GARANCISË PËR KREDITË RURALE (RCGF)



Falë bashkëpunimit të shkëlqyer, marrëdhënieve korrekte dhe transparente në zhvillimin e aktivitetit financiar, me RCGF, në muajin korrik 2016 FED invest mundi që të sigurojë një tjetër garanci financiare një vjeçare, me kosto ulët, në vlerën prej €500,000. Kjo garanci i shtohet asaj ekzistuese prej €750,000 duke e çuar vlerën totale të kësaj linje garancie në €1,250,000.

FOND GARANCIE PËR RRRITJEN E PUNËSIMIT DHE AKSESIT NË SHËRBIMET FINANCIARE TË POPULLSISË RURALE



Në kuadër të Programit të Komisionit Europian për Punësimin dhe Inovacionin Social që synon zbatimin e strategjisë Europa 2020. FED invest dhe Fondi Europian i Investimeve pritet të nënshkruajnë në Qershor 2017 marrëveshjen për Instrumentin e Garancisë Financiare. Objekti i marrëveshjes është një fond garancie për mbulimin e rrezikut për volumin e kredive që FED invest parashikon të disbursojë gjatë viteve 2017-2020. Volumi i kredive të reja të parashikuara për t'u shpërndarë nga FED invest tek anëtarët e tij gjatë kësaj periudhe, subjekt i kësaj marrëveshjeje është €30 milionë.



TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Në frontin teknologjik, pas një pune gati një vjeçare, në vitin 2016 FED invest arriti që të implementojë me sukses sistemin e përpunimit të informacionit të klientëve dhe llogarive të tyre në distancë, i quajtur Branchless Banking, falë mbështetjes të jashtëzakonshme të JICAs. Aktualisht kjo platformë është në zhvillim të mëtejshëm dhe e konceptuar përreth ofrimit të shërbimit ndaj klientëve dhe anëtarëve në çdo zyrë brenda të njëjtit rreth.

Gjithashtu, po këtë vit u mundësua vendosja e komunikimit elektronik nëpërmjet Internetit mobile 3G/4G të 28 degëve të FED invest. Sa më lart, mundësojnë një eksperiencë të përmirësuar cilësisht sa i takon komunikimit të të dhënave në mënyrë elektronike ndërmjet degëve dhe zyrës qendrore. Ky projekt risi përmirëson edhe më tej efikasitetin dhe eficiency e operacioneve të përditshme të Institucionit.

RRITJE PROGRESIVE

- AKTIVITET PËR 1,100 FSHATRA TË SHQIPËRISË
- 70 DEGË NË TË GJITHË VENDIN
- MË SHUMË SE 40,000 ANËTARË
- 750 TË ZGJEDHUR
- 12 DEGË TË REJA TË HAPURA NË VITIN 2016
- IMAZH I RI KORPORATIV



Shtirje e aktivitetit në:

1. Lezhë
2. Përmet



PASQYRAT E POZICIONIT FINANCIAR

Më 31 Dhjetor 2016

(në mijë lekë, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Aktivitet	31-Dec-2016	1-Feb-2016
Mjete monetare	303 157	355 473
Depozita ne Banka	101 755	-
Letra me vlerë (Eurobond)	122 401	-
Kredi neto	2 881 404	2 518 819
Aktivitet afatgjata materiale	28 777	8 305
Aktivitet afatgjata jomateriale	8 753	-
Aktive të tjera	93 124	50 208
Totali i aktiveve	3 539 371	2 932 805
Detyrimet		
Hua afatshkurter	163 060	-
Hua nga Unioni SHKK	115 981	94 622
Depozitat	2 746 642	2 412 817
Rezervat për kredi standart	56 998	49 489
Grande të amortizueshme	4 190	5 137
Detyrime të tjera	105 021	28 618
Totali i detyrimeve	3 191 892	2 590 683
Kapitali		
Kapitali i paguar	133 316	131 610
Rezervat	207 523	207 523
Rezultati i periudhës	2 989	-
Teprica (deficit) i mbartur	3 650	2 989
	347 479	342 122
Total i detyrimeve & kapitalit	3 539 371	2 932 805

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Më 31 Dhjetor 2016

(në mijë lekë, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

31-Dec-2016

Të ardhurat nga interesat e kredisë	392 728
Shpenzime për interesat	(71 294)
Të ardhura neto nga interesi	321 434
Rimarrje /Shpenzime nga zhvlerësimi i huave	(39 509)
Të ardhura neto pas zhvlerësimit	(39 509)
Të ardhura nga komisionet	36 618
Totali i të ardhurave nga komisionet	36 618
Të ardhura nga investimet	5 510
Shpenzime interesa për huatë	(12 567)
Të ardhura /(shpenzime) jo operative neto	202
Totali shpenzimeve financiare	(6 854)
Shpenzime për personelin	(186 265)
Shpenzime administrative	(117 081)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(4 693)
Totali i shpenzimeve	(308 039)
Teprica/ (deficiti)	3 650

RAPORT I AUDITIT TË JASHTËM



Grant Thornton Sh.p.k.
Rr: Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D,
Shk. B, Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 4 22 74 832
F +355 4 22 56 560
www.granthornton.al

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Këshillin Drejtues të FED invest

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë së Kursim Kreditit FED invest (“Organizata”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2016, pasqyrën të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Organizatës janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me ligjin shqiptar “Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Mbi mbikëqyrjen e shoqërive të kursim kreditit dhe unioneve të tyre”.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga entiteti në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

RAPORT I AUDITIT TË JASHTËM

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me me ligjin shqiptar “Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Mbi mbikëqyrjen e shoqërive të kursim kreditit dhe unioneve të tyre”, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë entitetin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të entitetit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomaliave materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurën auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencën auditimi të plotë dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurën të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

RAPORT I AUDITIT TË JASHTËM (vazhdim)


- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Kledian Kodra, FCA

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
6 prill 2017





Rryeti

FEDinvest

25 VJET FINANCË SOCIALE



INIBA

Rr. Qemal Stafa, pll.9 Katësh,
Nr.70, Pazar i Ri



TIRANË Rurale

Rr. Derhemi, Pallati Son



TIRANË Urbane

Rr. Muhamet Gjollësia, Pallati nr.15



ELBASAN

Rr. Qemal Stafa, Përballë Muzeut
Etnografik



KORCË

Lagja 9, Rruga Midhi Kostani



POGRADEC

Lagja 3, Rr.Fan Noli, Pallati Xhemollari



LIBRAZHD

Lagja nr 2, Rr.Adrian Edgar



PEQIN

Blvd. Mustafa Gjinishi, Lagja Teqe,



GRAMSH

Lagja Sporti, Pallati Osmani



LUSHNJE

Rr. Kongresi i Lushnjes



BERAT

Lagja 22 Tetori, Sheshi Agjensia, Vila e Zeres



DURRËS

Lagjia Nr 3 Rruga Tregtare, Godina Nr.97



KAVAJË

Blvd "Indrit Cara", Lagjja Nr. 4



SHKODËR

Blvd Zogu i Parë, Lagja "Manush Alimani", Pallati. Nr.10



VLORË

Lagja "Skelë", Rruga "Ismail Qemali", Pallati Xhaxho



FIER

Lagja Kastrioti, Rruga Brigada XI Sulmuese, përballë DPTT



SARANDË

Lagja Nr.1, Rruga Skënderbeu, Godina nr.11



LEZHË

Lagja Besëlidhja, Rr. Kosova, pll. 181



PËRMET

Lagja Varosh, Rr. Meleq Gosnishti,
përballë Gjykatës së Rrethit

ANËTARË / KLIENTË TË FED INVEST



Rrethi Fier



Rrethi Pogradec



Rrethi Korçë



Rrethi Vlorë



Rrethi Shkodër



Rrethi Tiranë



Rrethi Berat



Rrethi Sarandë



Rrethi Elbasan

FEDinvest 

www.fedinvest.al

2016
RAPORT VJETOR